

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Enver Peci, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve Q. B. nga P., A. D. nga fshati P., Komuna e D. dhe Z. M. nga fshati K., Komuna e I., kundër të paditurës – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i vendimit-aktit administrativ, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.163/2017 dt.25.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 19.07.2017, mori këtë

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësve Q. B., A. D. dhe Z. M., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.163/2017 të datës 25.05.2017.

### **A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.163/2017 të datës 25.05.2017, është refuzuar ankesa e paditësve Q. B., A. D. dhe Z. r M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.U.nr.524/2017 dt.04.04.2017, me të cilin është hedhur poshtë si i palejuar propozimi i paditësve të cilët kanë kërkuar nga gjykata caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.163/2017 dt.25.05.2017, paditësit kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe të shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që ta aprovohet kërkesa, të anulohet aktvendimi i kontestuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.163/2017 dt.25.05.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve Q. B., A. D. dhe Z. M. paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.U. nr.524/2017 dt.04.04.2017, me të cilin është hedhur poshtë propozimi i paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësve gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë A.U nr.524/2017 dt. 04.04.2017.

Neni 63 (LKA) parashikon se nëse ky Ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktin administrativ, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

Mirëpo, neni 22.2 i Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi, akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispoziten e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të paraparë në nenin 22 par.2 të LKA-së. Në rastin konkret, sipas interpretimit të drejtë, është dashtë që paditësit të kërkojnë nga gjykata e shkallës së parë shtyerjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, si në vështrim të nenit 22.6 LKA, e jo të nenit 306 LPP i zbatueshëm sipas nenit 63 (LKA), mu për këtë arsye, sepse neni 63 (LKA) zbatohet vetëm nëse ky ligj (LKA) nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktin administrativ.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është hedhur poshtë si i palejuar propozimi i paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për konfliktin administrativ. Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

ARJ-UZVP nr.41/2017 dt. 19.07.2017

Procesmbajtësi,

Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi